



Komuna e Deçanit  
Komisioni për ndarjen e Bursave  
Datë: 19.08.2021

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, Vendimit të Asamblesë Komunale të Deçanit Nr. 01/ IX-11 datë 29.06.2021, Komuna e Deçanit hap:

## KONKURS

### PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË DEÇANIT

I. Komuna e Deçanit ndanë gjithsej 65 bursa, për studentët e studimeve bachelor të cilët studiojnë në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës, për vitin akademik 2019-2020.


#### II. Kushtet për konkurrim për bursë komunale:

- Të jetë banor i Komunës së Deçanit,
- Të jetë student i rregullt në vitin akademik 2019-2020, në ndonjërin nga Universitetet Publike të Republikës së Kosovës,
- Të jetë student i nivelit Bachelor,
- Të mos e ketë përsëritur (humbur) vitin akademik,
- Të jetë student i vitit të dytë e më lartë,
- Të ketë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak të studimeve në afatin e shtatorit.

#### III. Kriteret për përzgjedhjen e përfituesve të bursave komunale:

Përzgjedhja e përfituesve të bursave komunale bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat, bazuar në kriteret e specifikuar më poshtë.

Nëse një kandidat plotëson më shumë se një nga kriteret/kategoritë e mëposhtme, atëherë mbledhet totali i pikëve të fituara nga secila kategori (përveç pikëve për notë mesatare, të cilat i fiton varësisht prej notës mesatare që ka kandidati). Nëse kandidatët mbledhin me pikë të barabarta, atëherë vendoset duke i dhënë përparësi Fëmijëve të dëshmorëve dhe martirëve të luftës së fundit në Kosovë, personat me nevoja të veçanta, me asistencë sociale, fëmijët me njërin prind ose asnjërin prind dhe gjinia femërore.



| Nr | Kriteri/Kategoria                                                                                                                                                                                 | Pikët |
|----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| 1. | Nota mesatare mbi 9 (nëntë)                                                                                                                                                                       | 40    |
|    | Nota mesatare mbi 8 (tetë)                                                                                                                                                                        | 30    |
|    | Nota mesatare mbi 7 (shtatë)                                                                                                                                                                      | 10    |
| 2. | Studentët me nevoja të veçanta                                                                                                                                                                    | 30    |
| 3. | Studentët me asistencë sociale                                                                                                                                                                    | 15    |
| 4. | Studentët – fëmijët me njërin prind ose pa asnjërin prind                                                                                                                                         | 15    |
| 5. | Studentët - fëmijët e dëshmorëve dhe viktimave civile (Martirëve)                                                                                                                                 | 20    |
| 6. | Studentët - fëmijët e invalidëve, veteranëve të UÇK-se dhe të burgosurve politik.                                                                                                                 | 10    |
| 7. | Studentët që kanë edhe ndonjë anëtar tjetër të familjes së ngushtë në studime (motër, vëlla, prind, fëmijë). Anëtari tjetër mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Bachelor ose Master). | 05    |
| 8. | Studentët në Fakultetin e Mjekësisë, Shkencave Matematiko - Natyrore, Ndërtimtarisë, Inxhinjerisë Elektrike dhe Kompjuterike, Inxhinjerisë Mekanike dhe Arkitekturës.                             | 20    |

- IV. Studentet duhet ti mbledhin minimumin 40 pik nga kriteret e larte cekura
- V. Statuset e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante, siç përshkruhet më poshtë.
- VI. Konkursi vlenë për të gjithë studentët e Komunës së Deçanit, të cilët studiojnë në ndonjë Universitet Publik të Republikës së Kosovës.

#### **Aplikacioni duhet të ketë këto dokumente të përgjithshme:**

- Formularin e aplikimit të plotësuar (merret në zyrën nr.52 në katin e tretë) ose shkarkohet nga faqja e Komunës <https://kk.rks-gov.net/decan/category/njoftimetshpalljet/>
- Dokumentin personal (letërnjoftimin ose pasaportën),
- Ekstraktin e lindjes,
- Kartelën Identifikuese të studentit,
- Vërtetimin nga Universiteti Publik (fakulteti apo departamenti përkatës) se kandidati është student i/e rregullt në vitin akademik 2020-2021, duke specifikuar fakultetin/drejtimin e studimeve dhe që kandidati nuk ka përsëritur (humbur) ndonjë vit akademik.
- Certifikatën e notave të studimeve (Origjinale),
- Konfirmimin e Llogarisë Bankare

Studentët e kategorive të shënuara më lartë duhet të dorëzojnë këto dokumente të veçanta:

- Studentët me nevoja të veçanta, vërtetimin nga institucioni përkatës,
- Studentët me asistencë sociale, vendimin nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe certifikatën familjare,
- Studentët me njërin prind ose asnjërin prind certifikatat e vdekjes së prindërve,

- Studentët – fëmijët e Dëshmorëve/viktimave civile, vendimin se është përfitues i pensionit nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe certifikatën familjare,
- Studentët – fëmijët e Invalidëve të luftës, vendimin se është përfitues i pensionit nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe certifikatën familjare,
- Studentët – fëmijët e Veteranëve dhe të burgosurve politik, vendimin se është përfitues i pensionit nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe certifikatën familjare,
- Studentët që janë dy apo më shumë nga familja e ngushtë, dëshmi nga Fakulteti për statusin e studentit të anëtarit tjetër të familjes dhe certifikatën familjare,

### **Sqarime shitesë**

**Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.**

**Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente përkatëse.**

**Afati dhe mënyra e aplikimit:**

**Konkursi është i hapur prej datës 19 Gusht 2021 ne afat prej 15 dite. Aplikacionet dorëzohen në zyrën e arsimit nr. 17 në katin e parë në Komunën e Deçanit. Përfituesit e bursave do të informohen pas përzgjedhjes finale dhe rezultatet do të publikohen në webfaqe të Komunës së Deçanit.**

Kryetarja e Komisionit

**Znj. Dafina Cacaj**

